



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË
KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS PËR QËLLIME TË
VEÇANTA MBI RENTËN MINERARE TË PAGUAR PËR
LICENCAT PËR VITIN 2025**

Prishtinë, shkurt 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

Shtojca II: Letër konfirmimi

1 Opinioni i Auditimit

Ky raport përmbledh çështjet kryesore nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor për Qëllime të Veçanta mbi Rentën Minerare të paguar për Licencat (në vijim: Raporti) për periudhën 1 janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025 të Korporatës Energjetike të Kosovës (në vijim: ndërmarrja), i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i raportit për qëllime të veçanta për periudhën audituese është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin.

Për raportimin menaxherial, për kontrollet dhe zbatimin e rekomandimeve nuk kemi çështje për të ngritur.

1.1 Opinioni i auditimit për Raportin Financiar Vjetor mbi Rentën Minerare të paguar për Licencat

Auditimi i raportit për qëllime të veçanta merr parasysh pajtueshmërinë me kërkesat e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (Rregullatori) në pajtim me Ligjin nr. 03-L-163 për Minierat dhe Minerale, si dhe Ligjin nr. 04/L-158 me ndryshim dhe plotësim, lidhur me cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në raport nga ndërmarrja.

Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar Raportin Financiar Vjetor për Qëllime të Veçanta mbi Rentën Minerare të paguar për Licencat e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a të datës 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Raporti është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat ligjore të Rregullatorit.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Raportit Financiar Vjetor". Në përputhje me ONISA - P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e raportit të ndërmarrjeve, dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga entiteti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i Çështjes - Baza për kontabilitet

- 1 Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 2, i cili përshkruan bazën kontabël, duke theksuar se raporti është përgatitur në përputhje me kornizën për qëllime të veçanta prandaj raporti nuk mund të përdoret për qëllime tjera.

Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e raportit në përputhje me kërkesat e nenit 34 të Ligjit nr. 03-L-163 për Minierat dhe Mineralet, Ligjit nr. 04/L-158 me ndryshim dhe plotësim dhe për kontrollet e brendshme që menaxhmenti i vlerëson të domosdoshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit pa keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

Për përgatitjen e raportit, menaxhmenti ka përgjegjësi të vlerësojë aftësinë e ndërmarrjes për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi - duke dhënë informacione shpjeguese, nëse është rasti për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë - përveç rastit kur menaxhmenti synon ta likuidojë ndërmarrjen ose t'i ndërpresë aktivitetet, apo nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveçse të veprojë si më sipër. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit të ndërmarrjes.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI (KDPI). Ky ligj dhe këto standarde kërkojnë që t'u përmbahemi kritereve etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se raporti nuk përmban keqdeklarime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmive të auditimit lidhur me raportin. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të keqdeklarimeve materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Auditimi po ashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura, arsyeshmërisë së vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të raportit.

Gjatë kryerjes së procedurës për vlerësimin e rrezikut, ne e marrim parasysh kontrollin e brendshëm përkatës në lidhje me deklaratimet e Menaxhmentit dhe përgatitjen e raportit për qëllimet e kërkesave ligjore të Rregullatorit nga entiteti, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit lidhur me efektshmërinë e tij. Sidoqoftë, ne do t'ju komunikojmë me shkrim për ndonjë mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që është relevante me auditimin e raportit të cilat i identifikojmë gjatë auditimit.

2 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

ZKA në bazë të kërkesës së ndërmarrjes, si dhe përfshirjes në planin vjetor të auditimit, është përgjegjese për kryerjen e auditimit të rregullsisë. Ky auditim përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e raporteve financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse raportet financiare vjetor për qëllime të veçanta japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin si dhe detyrat shtesë sipas procedurave të dakorduara;

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar raportimin për qëllime të veçanta, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlikuara substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshëm për kryerjen efektive të auditimit.

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Xhemile Berisha - Hoti, Udhëheqëse e ekipit



Lindita Ajeti, Anëtare e ekipit



Alban Shatri, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit - d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI I SHIKIMIT / DATE OF CHECKING: 27-02-2026			
Niveli Org. Org. Jedr. Org. Unit	Shk. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Fajdes No. Stranas No. Pages
05	47	285	1



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH. A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me draft raportin e Auditorit të Përgjithshëm për qëllime të veçanta mbi rentën minerare të paguar për licencat për vitin 2025

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit


Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft-raportin e auditimit për raportin financiar vjetor të Korporatës Energjetike të Kosovës për qëllime të veçanta mbi rentën minerare të paguar për licencat për vitin 2025. (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre (nëse ka).

z. Valdrin Krasniqi

Kryesues i Bordit të "Korporata Energjetike e Kosovës" sh. a.,



Data: 26/02/2026



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

RAPORTI VJETOR MBI RENTËN MINERARE TË PAGUAR PËR LICENCAT:

Licencës nr. 2310/KPMM/2024

Licencës nr. 559/ICMM/06

SË BASHKU ME RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

TABELA E PËRMBAJTJES

PAGESAT E TANTIEMES TË KRYERA PËR SASINË E THENGJILLIT TË NXJERRË GJATË VITIT 2025	4
SHPENZIMET E KRYERA.....	5
1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME	6
2. BAZA E PËRGATITJES	7

KORPORATA ENERJITIKE E KOSOVËS SH.A
RAPORTI PUNES VJETORE MINERARE

PASQYRA VJETORE E PRODHIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË QYMYRIT
NUMRI I LICENCËS 2310/KPMM/2024

Periudha kohore e raportimit	Rezerva të shfrytëzuara	Tantiema për ton	Tantiema e paguar
Njësia	në ton	EUR/ton	në EURO
01 Janar 2025– 31 Mars 2025	2,121,120	3	6,363,360
01 Prill 2025 – 30 Qershor 2025	1,437,067	3	4,311,201
01 Korrik 2025 – 30 Shtator 2025	1,414,606	3	4,243,818
01 Tetor 2025 – 31 Dhjetor 2025	1,975,223	3	5,925,669
TOTAL			20,844,048

PASQYRA VJETORE E PRODHIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË QYMYRIT
NUMRI I LICENCËS 559/ICMM/06

Periudha kohore e raportimit	Rezerva të shfrytëzuara	Tantiema për ton	Tantiema e paguar
Njësia	në ton	EUR/ton	në EURO
01 Janar 2025– 31 Mars 2025	-	3	-
01 Prill 2025 – 30 Qershor 2025	-	3	-
01 Korrik 2025 – 30 Shtator 2025	-	3	-
01 Tetor 2025 – 31 Dhjetor 2025	-	3	-
TOTAL			-

PAGESAT E TANTIEMES TË KRYERA PËR SASINË E THENGJILLIT TË NXJERR GJATË VITIT 2025

Periudha kohore e raportimit	Data e pagesës	Shuma e paguar	Monedha
01 Janar 2025– 31 Mars 2025	14.04.2025	6,363,360	EUR
01 Prill 2025 – 30 Qershor 2025	15.07.2025	4,311,201	EUR
01 Korrik 2025 – 30 Shtator 2025	15.10.2025	4,243,818	EUR
01 Tetor 2025 – 31 Dhjetor 2025	14.01.2026	5,925,669	EUR
Totali paguar për vitin 2025		20,844,048	EUR

Tantiema për tu paguar për secilën licencë			
Numri i licencës 2310/KPMM/2024		20,844,048	EUR
Numri i licencës 559/ICMM/06		-	EUR
Total tantiema për tu paguar për vitin 2025		20,844,048	EUR
Diferenca		-	

REZERVAT E SHFRYTËZUESHME NË FUND TË PERIUdhËS

Periudha kohore e raportimit	Rezerva të shfrytëzueshme ne fillim të periudhës	Rezerva të shfrytëzuara	Rezerva e shfrytëzueshme në fund të periudhës
01 Janar 2025 – 31 Mars 2025	30,486,872.00	2,121,120.00	28,365,752.00
01 Prill 2025 – 30 Qershor 2025	28,365,752.00	1,437,067.00	26,928,685.00
01 Korrik 2025 – 30 Shtator 2025	26,928,685.00	1,414,606.00	25,514,079.00
01 Tetor 2025 – 31 Dhjetor 2025	25,514,079.00	1,975,223.00	23,538,856.00
Total viti 2025	30,486,872.00	6,948,016.00	23,538,856.00

SHPENZIMET E KRYERA

	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2025 (në EUR)
SHPENZIMET OPERATIVE	
Zhvlerësimi dhe amortizimi	16,901,250.00
Shpenzimet e personelit	33,997,538.00
Nafta	1,668,909.00
Kostot e mirëmbajtjes	496,472.00
Materialet dhe furnizimet	3,760,931.98
Tantiema e qymyrit	20,844,048.00
Shpenzimet për testime dhe analiza	26,004.00
Shpenzime të sigurimit	877,392.00
Konsumi i energjisë	3,269,234.93
Shpenzimet e interesit	2,499,401.00
Të tjera shpenzime	284,053.00
Taksa tjera KPMM	7,395.00
Total shpenzimet	84,632,628.91

* Përfitimet nuk janë paraqitura, për shkak se shitjet konsiderohen transaksione interne ndërmjet minierës dhe termocentraleve.

Deklaratat vjetore janë të aprovuara nga Menaxhmenti dhe të nënshkruara në emër të tyre më 13 shkurt 2026:


Z. Gramos Hashani
UD Kryeshef Ekzekutiv


Z. Arsim Krasniqi
UD Drejtor Ekzekutiv i Mihjeve


Z. Gëzim Paçi
UD Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. ("Kompania" ose "KEK") është shoqëri aksionare inkorporuar në Kosovë dhe e regjistruar nën Agjencinë e Regjistrimit të biznesit në Kosovë nën numrin e regjistrimit 7032599 me datë 27 dhjetor 2005. Kompania u transformua në një ndërmarrje aksionare (Sh.A.) nën Misionin e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara ("UNMIK") rregullorja nr. 2001/6. Adresa e selisë qendrore së saj të regjistruar është: Rruga Nënë Tereza Nr. 36, 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Kapital fillestar i regjistruar i Kompanisë arrin në 25 mijë euro.

Kompania është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë gjenerimi energjise dhe aktivitetet minerare si nxerrja e linjtit duke përdorur termocentralet e tij.

Struktura aktuale operative e Kompanisë përbëhet nga zyra qendrore e korporatës dhe divizionet e mëposhtëm:

- Divizioni i prodhimit të Linjtit;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova A;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova B;

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova A për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2023 deri më 4 tetor 2024 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_A) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Për shkak të paaftësisë së Kompanisë për të marrë Lejen e Integruar Mjedisore nga MMPH licenca për Kosovën A rinovohet çdo vit.

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova B për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2006 deri më 4 tetor 2026 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_B) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Ndërsa më 13 prill 2017, Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A), Divizioni i Prodhimit "TC Kosova B", me numër licence ZRRE / Li_05 / 14_B, është modifikuar në "Licencë e Kogjenerimit të Energjisë Elektrike dhe Termike" me numër të ri licence ZRRE / Libp_05 / 17_B lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), të gjitha dispozitat e tjera të licencës së mëparshme mbeten në fuqi.

Ndërsa më 20 dhjetor 2018, Korporatës Energjetike të Kosovës ishte pajisur me licencën e re ERO/ Li_60 / 17 për Furnizim me Energji Elektrike me vlefshmëri nga 20 dhjetor 2018 deri më 19 dhjetor 2043.

Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SHA) gjatë dhjetorit 2014 filloi projektin për Kogjenerimin e Energjisë Termike ku energjia termike i shitet Termokos Sh.A me qëllim të sigurimit të furnizimit me ngrohje në Prishtinë.

2. BAZA E PERGATITJES

Bazuar në kërkesat e nenit 34 pika 4 të ligjit nr. 03/L-163 PËR MINIERAT DHE MINERALET

Bartësi i Licencës për shfrytëzim do t'i dorëzojë KPMM-së:

- një raport për vitin përkatës kalendarik që siguron: një përmbledhje të të gjitha rezultateve të aktiviteteve të shfrytëzimit; detaje të sakta për tonazhin, vëllimin, përbërjen, shkallën dhe vlerën e mineraleve të prodhuara; detaje mbi tonazhin dhe vëllimin e mbeturinave të larguara dhe mënyra se si ato janë hedhur; një deklaratë të hollësishme mbi shpenzimet, kostot dhe personat e punësuar; si dhe një vlerësimin të rezervave të mbetura minerale, të ilustruar me plane dhe seksione në përmasat e duhura, mbi aksidentet dhe sigurinë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe mbi aktivitetet e rikultivimit;
- deklaratat e audituara për atë vit kalendarik mbi shpenzimet;
- një deklaratë të audituar që tregon shumën e rentës minerare që duhet paguar për këtë vit kalendarik, së bashku me të gjitha informatat dhe llogaritjet e tyre, dhe të gjitha ndryshimet dhe shpjegimet e nevojshme për harmonizimin e deklaratës vjetore me të gjitha deklaratat e dorëzuara më parë ;
- një raport të audituar financiar që tregon përfitimet dhe humbjet si dhe gjendjen financiare të bartësit të Licencës në fund të atij viti kalendarik.